



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:213498

Datë: 20.11.2019

Numri i dokumentit: 00663760

P.nr.1019/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale, me gjyqtarin e vetëm gjykues Ilir Bytyqi dhe asistentin Muedin Rexhepi, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.A.1 nga Ferizaj, për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1487-13/19 të datës 25.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në prani të prokurores së shtetit Luljeta Bilalli, të dëmtuarve V... dhe A.A.2 si dhe të akuzuarit A.A.1, me datën 24.10.2019, morri dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datën 05.11.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit: A.A.1 nga Ferizaj, Rr. ...”, nr..., i lindur me ..., në fshatin ..., Komuna Ferizaj, nga i ati H... dhe e ëma A..., e gjinisë B..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes mesme ekonomike, posedon letërnjoftim me numër personal

Konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së

REFUZOHET AKTAKUZA

Se me datë 16.07.2019, rreth orës 19:00, në rrugën ..., nr. ... Ferizaj, me dashje e dëmton pasurinë e shtëpisë së nënës së tij, tani të dëmtuarës A.A.2, në atë mënyrë që ditën kritike derisa kishte qenë nën ndikimin e alkoolit 2.92 promila në gjak, kishte thyer dyert, dritaret e shtëpisë, vazën e luleve si dhe ulëset (karriget) që gjendeshin në oborrin e shtëpisë.

**me këtë do të kryente veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321
par.1 të KPRK-së**

- Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në shqyrtimin fillestar.
- Të dëmtuarit: V.A dhe A.A.2 nga Ferizaj, rr..., nr.... nuk kanë paraqitur kërkesë pasurore-juridike.
- Shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitura për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi vepra penale për të cilën është proceduar i akuzuari, gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues.

Prokuroria Themelore Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.1019/19 të datës 25.09.2019 ka ngarkuar të akuzuarin A.A.1 nga Ferizaj, për veprën penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 24.10.2019 ku kanë prezantuar prokurorja e shtetit Lulejeta Bilalli, të dëmtuarit V... dhe A.A.2 si dhe i akuzuari A.A.1.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues ka njoftuar të dëmtuarit V.A dhe A.A.2, konform nenit 335 të KPRK-së, se nëse vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, është kryer ndaj personit të cilin kryesi e ka anëtar të familjes, procedura penale fillohet sipas propozimit kur shuma e dëmit është më pak se 250 euro /dyqind e pesëdhjetë/.

Përkitazi me këtë të dëmtuarit V.A dhe A.A.2 kanë deklaruar se me qenë se i akuzuari është vëllai, përkatësisht djali i sajë, nuk japin propozimin për ndjekje penale, ndërsa shuma e dëmit të shkaktuar nga i akuzuari nuk tejkalon vlerën e 40 Eurove.

Pas dëgjimit të të dëmtuarve, prokurorja e shtetit Luljeta Bilalli në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se nuk e kundërshtojnë propozimin e palëve të dëmtuara pasi nga ta mësuam se vlera e dëmit të shkaktuar nga i akuzuari është në vlerën prej 40 Euro, e duke pas parasysh dispozitën e nenit 335 të KPRK-së, ku parashihet se vepra penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, ndiqet sipas propozimit të palës së dëmtuar, ne si prokurori tërhiqen nga ndjekja penale ndaj të akuzuarit duke i propozuar gjykatës që të merr aktgjykim refuzues.

Pasi prokurorja e shtetit ka hequr dorë nga ndjekja penale, gjykata duke vepruar konform nenit 363 par. 1 pika 1.1 të KPPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit Veton dhe A.A.2 nga Ferizaj, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike, andaj nuk është udhëzuar për realizimin e sajë.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 454 par.1 të KPPK-së.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

P.nr.1019/19, me datë 05 Nëntor 2019

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ilir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.